



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2001/9 prot.

Datë 20.09.2023

V E N D I M
Nr. 935/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.09.2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Korrigjim Vendimi.

Subjekte të interesuar Spitali Rajonal Vlorë me adresë Lagjja “Partizani”.

Operatori ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK me NIPT L81422033E me adresë “Njësia nr. 8, Rruga Siri Kodra, Objekti nr. 198-Tiranë

Agjencia e Prokurimit Publik
Blv. "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave,
Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 112 e 129 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik dhe neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së

Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik,

Vëren:

I

Në datën 23.08.2023, përmes vendimit Nr. 803/2023, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Distributor of Medical Devices” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-77239-08-10-2023, me objekt **Objekti i kontratës/ Marrëveshjes Kuadër: “Blerje Tuba dhe Materiale konsumi laboratorike për nevoja të SRV” ndarë në 2 (dy) Lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, Loti 1 REF-77241-08-10-2023, Loti 1 “Blerje tubave/sistemeve të marrjes së gjakut” (në zbatim të kontratës koncesionare të laboratorëve), me fond limit Loti 1: 5,539,950 (Pesë milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 21.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.***
2. *Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Distributor of Medical Devices” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Komisioni i Prokurimit Publik

Arsyeton:

I.1.Me nismën e vetë organit administrativ, nga Komisioni i Prokurimit Publik, konstatohet se në Vendimin KPP 803/2023 të datës 23.08.2023, kudo në vendim është shkruar gabim emri i operatorit ekonomik “Distributor of Medical Devices” SHPK.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 112 e 129 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe

funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik dhe neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Vendos

Të korrigjojë vendimin Nr. 803/2023 të datës 23.08.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, kudo, si më poshtë:

ISHTE:

operatori ekonomik “Distributor of Medical Devices” SHPK

BËHET:

Operatori ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anila Malaj

Kryetar

Jonaid Myzyri